



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr / Br 93/23
Nr. i fq. / Br. st. - 4 -
Datum / Datum: 12.04.2023
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

në mbledhja e III-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 mars 2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Maxhuni, Agron Perçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia, (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i Komunës), Shpëtim Zhegrova (Nënkyryetar i Komunës), drejtoret e drejtive, Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoj Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na kanë ardhur edhe tri pikë shtesë për të cilat do të diskutojmë nëse do të kemi mundësi t'i shtojmë në rend të ditës:

- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;
- Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për vitin 2022;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të komisionit për përgjedhjen e Këshillave lokale.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – propozoi që të futet në rend të ditës dhe të procedohet për kuvend <Ofrimi i ndihmës financiare për Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt, si rezulat i dëmeve nga vërshimet, si dhe ofrimin e ndihmës financiare për shtetin e Turqisë dhe Sirisë, si pasojë e tërmetit> Kishte me qenë mirë që në mënyrë simbolike të ndajmë mjete financiare dhe të trejgmë solidaritet, sepse e dimë që fuqia financiare e komunës është e kufizuar.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri vendosi që t'i fus në rend të ditës pikat shtesë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 10.2.2023;
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022;
3. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. 01.49/20 i datës 27.02.2020;
 6. Shqyrtimi i Raportit i vlerësimit të dëmeve nga shiu, era dhe zjarri;
 7. Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;
 8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për vitin 2022;
 9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale;
 10. Ofrimi i ndihmës financiare për Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt, si rezulat i dëmeve nga vërshimet, si dhe ofrimin e ndihmës financiare për shtetin e Turqisë dhe Sirisë, si pasojë e tërmetit;
 11. Të ndryshme.
-
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 10.2.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 10.2.2023.

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se gjatë vitit 2022 kemi pasur një vit jo të kënaqshëm në realizimin e planeve investuese. Ai kërkoi nga Kryetari i komunës që këtë vit të jetë më azhur dhe të fillojë me kohë procedurat për projektet, e sidomos ato për investime kapitale, në mënyrë që të realizohen investimet, ku qytetarët kanë nevojë. Ai tha se në muajin e kaluar ka qenë e planifikuar të vjen propozimi për ndarjen e subvencioneve, por nuk ka ardhur. U tha që do të thërrasim mbledhje të jashtëzakonshme të KPF-së, as kjo nuk ndodhi.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë.

Medina Bunjaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – theksoi se është një gabim teknik në preambulë, ku propozimi është thirr në statutin e vjetër, prandaj për kuvend do ta përmirësojmë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. 01.49/20 i datës 27.02.2020.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Raportit i vlerësimit të dëmeve nga shiu, era dhe zjarri.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – kërkoi që të riformulohet titulli i këtij raporti me qëllimin më të mirë që jetë konform kërkesave. Pra, të jetë <Shqyrtimi i Raportit i vlerësimit të dëmeve nga shiu, era dhe vërvshimet>. Për shkak se sa i përket dëmeve nga zjarri nuk do të marrim ndonjë masë subvencionuese nga qeveria.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – pyeti se është krijuar komision për vlerësim të dëmeve në kulturat bujqësore si pasojë e vërvshimeve në janar 2023.

Maliq Ferizi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – tha se komisioni e ka bërë vlerësimin e dëmeve edhe të kulturave bujqësore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se deri tani kemi pritur nga niveli qendror (Ministria e Financave) për bartjen e të hyrave. Mirëpo, për shkak të afateve kohore dhe mjeteve financiare që kemi obligimeve të pa kryera nga ky fond. Ne kemi pasqyruar tabelën në kuadër të të hyrave të bartura: Paga dhe mëditje, kemi paraparë 20,000.00€; Mallra dhe shërbime, kemi planifikuar 1,890,427.37€; Shpenzime komunale, kemi planifikuar 20,000.00€; Subvencione dhe transfere, kemi planifikuar 266,100.00€ dhe Investime kapitale, kemi planifikuar 1,537,100.00€. Totali i mjeteve të bartura është planifikuar të jetë 2,733,627.37€.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – propozoi që të ndahen mjete financiare për kuvendin, sepse nuk qenkan planifikuar as në vija tjera buxhetore. Vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara tek Drejtoria për Administratë rrëth 80 mijë euro për furnizim me laptop për anëtarët e kuvendit. Ai për këtë vit propozoi që për nevojat e kuvendit nga të hyrat vetanake të caktohet vlera 150 mijë euro me përshkrimin <furnizim me laptop për anëtarët e kuvendit>, pjesa tjetër të mbetet për <zërim dhe votim elektronik për sallën e kuvendit> Një pjesë tjetër e mjeteve të mbetet për nevojat e kuvendit për organizimin eventual të ndonjë udhëtimi.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – tha se kur të rregullohet zërimi, të futet në specifikacion që të rregullohen edhe tavolinat. Pra, të merren tavolina tjera më të gjera, sepse këto aktuale janë të papërshtatshme për material, por edhe ulëset të jenë më të mëdha. Por, të mendohet ndoshta edhe për ndërtimin e një salle të re të kuvendit, me hapësirë më të përshtatshme

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – pyeti se ku është planifikuar që të bëhet pagesa e komisioneve të kuvendit.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se se pagesa e komisioneve do të bëhet nga kategoria <Paga dhe mëditje>.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që propozimet e dhëna të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për vitin 2022.

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – pyeti se a është dhënë në shfrytëzim ndonjë pronë gjatë vitit 2022 që nuk ka qenë më herët?

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se gjatë vitit 2022 nuk është dhënë në shfrytëzim asnjë pronë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

9. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për përzgjedhjen e Këshillave Lokale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.


10. Ofrimi i ndihmës financiare për Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt, si rezulat i dëmeve nga vërshimet, si dhe ofrimin e ndihmës financiare për shtetin e Turqisë dhe Sirisë, si pasojë e tërmetit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

11. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **11:10**.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe e KPF-së